



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2019:203894

Datë: 17.12.2019

Numri i dokumentit: 00734843

**P.nr. 985/2019**

### **NË EMËR TË POPULLIT**

#### **GJYKATA THEMELORE NË FERIZA-Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni**

**Penal**, si gjykatë e shkallës së parë penale, gjyqtari Adem Shabani me zyrtaren ligjore Kadishe Shabani, në çështjen penale kundër të pandehurave R.S dhe SH.S që të dy me vendbanim në fshatin Kaçanik i Vjetër, rruga .... ,Komuna Kaçanik, me çka në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale Vetëgjyqësi nga neni 410 par. 1 lidhur me 31 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr.1661-12/19 të dt.13.09.2019, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar në prani të përfaqësuesit të akuzës-prokurorit të shtetit Avdullah Abedini, të pandehurve me datën 17.12.2019, të njëjtën ditë shpalli këtë:

### **A K T G J Y K I M**

#### Kundër të pandehurve:

**1.** I pandehuri **R.S** me vendbanim në fshatin Kaçanik i Vjetër, rruga ... , Komuna Kaçanik, nga i lindur me dt....., i ati R..., e ëma L... e gjinisë C..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, ka të kryer shkollën e mesme, i pa punë,i martuar baba i dy fëmijëve i gjendjes së dobët ekonomike, me numër personal ..., mbrohet në liri,-

**2.** I pandehuri **R.S** me vendbanim në fshatin Kaçanik i Vjetër, rruga ... , Komuna Kaçanik, i lindur me dt.... ,nga i ati R..., e ëma L... e gjinisë C..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, ka të kryer shkollën fillore i pa punë, i gjendjes së dobët ekonomike, me numër personal ..., mbrohet në liri,-

## JANË FAJTOR

### SEPSE:

Me datë 06.08.2019, rreth orës 08:35, i pandehuri i shoqëruar me vllahun e tij SH.S, shkojnë në kompaninë për tërheqjen e veturave “F...” dhe pa e paguar obligimin për veturën Pickup Renault Kango me targa ... e cila paraprakisht ishte ndalur nga patrulla policore, për shkak se ka qenë e paregjistruar, të njëjtën veturë e marrin dhe largohen nga parking i kompanisë dhe më pas përsëri ndalohen nga patrulla e policisë.-

**- me çka në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale Veëgjyqësi nga neni 410 par. 1 lidhur me 31 të KPRK-së.**

Gjykata në bazë të neni 81 dhe 82 të KPRK-së, dhe nenit 498 dhe 499 të KPPRK-së, të pandehurve R.S dhe SH.S, i shqipton sanksion penal:

## VËREJTJE GJYQËSORE

**I. Të pandehurve R.S dhe SH.S**, i bëhet me dije se ka kryer një vepër të dëmshme dhe të rrezikshme, që përbën vepër penale dhe nëse kryen prapë vepër të tillë, gjykata do të shqiptoj sanksion më të rëndë penale.

Qëllimi i vërejtjes gjyqësore është që t'i jepet kryesit qortim, duke pasur parasysh të gjitha rrethanat në lidhje me veprën dhe kryesin, e në rastin konkret vërejtja gjyqësore është e mjaftueshme për të arritur qëllimin dënimit.

**II.** Obligohen të pandehurit në mënyrë solidare të paguaj paushallin gjyqësor në shumë prej nga 30 (tridhjetë) Euro, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm.

**III.** Të pandehurit **R.S dhe SH.S** Konform nenit 453 paragrafi 4 të KPPRK-së pjesërisht i ka obliguar për pagesën e paushallit gjyqësor kurëse i ka liruar që të paguan të pandehurit taksën mbështetur nenit 39 parag.1 nën par. 3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të krimit Nr.05/L-036. Pasi nëse i obligonte do të rrezikonte gjendjen material të të pandehurve ose të personave që ato detyrohen ti mbështesin materialisht.

**IV.** I dëmtuari A.R, me vendbanim në fshatin ... Komuna Ferizaj, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohen në kontest civil.

## A r s y e t i m

Prokurorisë Themelore në Ferizaj me aktakuzën PP/II.nr.1661-12/19 të dt.13.09.2019, ka ngarkuar të pandehurit R.S dhe SH.S që të dy me vendbanim në fshatin Kaçanik i Vjetër, rruga ... ,Komuna Kaçanik, me çka në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale Vetëgjyqësi nga neni 410 par. 1 lidhur me 31 të KPRK-së.

Gjykata duke vepruar rreth kësaj çështje penale konform nenit 245 par.1 të KPPK-së me dt.17.12.2019, ka mbajtur shqyrtimin fillestar në të cilin kanë marrë pjesë prokurori i shtetit Avdullah Abedin dhe të pandehurit R.S dhe SH.S, kurse i dëmtuari A.R është ftuar me ftes të rregullt por nuk është paraqitur në shqyrtim fillestar dhe mosardhjen nuk e ka arsyetuar.

Në fillim të shqyrtimin fillestar gjyqtari ka konstatuar se të pandehurit në afatin ligjor me kohë së bashku me ftesën për shqyrtim, ka pranuar edhe një kopje të aktakuzës.

Në fillim të shqyrtimit fillestar të pandehurit janë udhëzuar në kuptim të nenit 246.1 të KPPK-së pastaj gjyqtari gjykues ka çmuar se të drejtat e të pandehurve janë respektuar, e më pas prokurori i shtetit ka lexuar aktakuzën të pandehurve dhe pasi që gjyqtari është bindur se të njëjtit e kanë kuptuar në tërësi aktakuzën me të cilën janë ngarkuar, të njëjtit i ka dhënë mundësi të deklarohe mbi fajësinë apo pafajësinë e tij lidhur me veprën penale për të cilën akuzohen, dhe para se të deklarohe i pandehuri i parë nga salla e gjykimit largon të pandehurin e dytë.

I pandehuri R.S ka theksuar se e ndien veten fajtorë dhe e pranon fajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar dhe në vazhdim ka theksuar se ditën për të cilën akuzohet i' u është ndalur nga policia dhe se veturën, ka qenë e pa regjistruar dhe patrulla policore e ka konfiskuar me merimange ku aty isha duke punuar privat duke shtruar kocka te parku i lojërave në parkun e qytetit Ilirija, ku është marrë vetura e tij nga kompania për tërheqje dhe duke mos ditur se duhet të njoftoj organet kemi shkuar te kompania dhe kemi marrë veturën por nuk ka ditur se duhet me paguar por mase rastit ka shkua edhe e ka bërë pagesën, është hera e parë që ndeshet me ligjin dhe është penduar thelle për kryerjen e kësaj vepre penale, kërkon nga gjykata që të merr të gjitha rrethanat lehtësuese me rastin e shqiptimit të dënimit pasi nuk e ka gjendjen e mirë ekonomike dhe nëse gjënë punë privat punon për të mbajtur familjen.

I pandehuri SH.S ka theksuar se e ndien veten fajtorë dhe e pranon fajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar dhe është e vërtetë se atë ditë ishte së bashku me vllahun e tij R... ku ishte duke vozitur veturën, por një patrullë policore e ka konfiskuar pasi ishte e pa regjistruar dhe se vllahu nuk kishte me vete dokumente, dhe kemi shkuar me vllahun ku e kemi

marrë veturën te kompani ku ishte dërgua pasi ishim të revoltuar sepse me veturën në fjale mbajmë familjen duke shtruar kocka, dhe se automjetin e kemi si mjetë pune, por të dëmtuarit i kemi paguar borxhin kërkon nga gjykata që të merr të gjitha rrethanat lehtësuese me rastin e shqiptimit të dënimit pasi nuk e ka gjendjen e mirë ekonomike.

Pas pranimi të fajësisë nga ana e të akuzuarit gjyqtari në kuptim të nenit 248 par.2 të KPPK-së ka kërkuar edhe mendimin e prokurorit të shtetit lidhur me pranimin e fajësisë, mbrojtësit dhe të dëmtuarit.

Prokurori i shtetit Avdulla Abedini ka theksuar se pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit pasi pranimi i fajësisë është bërë konform ligjit si dhe në provat që gjinden në shkresat e kësaj lënde penale.

Gjykata në shqyrtimin fillestar ka vetëtuar se te akuzuarit pranimin e fajësisë e kanë mbështet në provat që gjinden në shkresat e kësaj lënde penale, raporti i policisë nr. 2019-CF-1393 i dt.06.08.2019, kallëzimi penal numri i rastit 2019-CF-1393 i dt.18.08.2019 deklarata e të dëmtuarit A.R dhënë në polici me dt.06.08.2019 dhe shkresat tjera që gjinden në lëndë.

Gjyqtari në kuptim nenit 248 par.1 nën.par.1.1, 1.2, 1.3, 1.4 dhe par.4 të KPPK-së, është e bindur se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë, pranimin e ka bërë vullnetarisht duke e mbështetur në provat që përmban aktakuza dhe në materialet e prezantuara nga ana e prokurorit të shtetit.

Vlerësuar nga aspekti juridik gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurëve manifestohen të gjitha elementet e veprës penale me çka në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale Vetëgjyqësi nga neni 410 par. 1 lidhur me 31 të KPRK-së.

Gjykata pasi analizoj të gjitha faktet e kësaj çështje penale, provave që gjinden në shkresat e lëndë ka aplikuar dispozitat ligjore të neneve 81, 82 të KPRK-së dhe neneve 498, 499 dhe 500 të KPPK-së dhe të pandehurve R.S dhe SH.S i ka shiptuar sanksionin penale vërejtje gjyqësore, duke pas parasysh të gjitha rrethanat në lidhje me veprën e kryer e në rasin konkret gjykata mendon se ky sanksion penal është i mjaftueshëm për të arritur qëllimin e dënimit.

Me shqiptimin e vërejtjes gjyqësore kryesit i bëhet me dije se ka kryer një vepër të dëmshme dhe të rrezikshme që përbën vepër penale dhe nëse kryesi prapa kryen veprime të tilla gjykata do ti shqiptoj sanksion ma të rëndë penal.

Konformë nenit 463 parag.1 lidhur me par 3.të KPPK-së të dëmtuarin A.R, me vendbanim në fshatin ... Komuna Ferizaj, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike janë udhëzuar në kontest civil.

Vendimi mbi kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale- paushallit gjyqësor është sjell në bazë të nenit 450 par.2 nënpar.2.6 KPPK-së .

Nga sa u tha më lart është vendosur si në diapozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**

Departamenti i përgjithshëm-divizioni penal,

**P.nr.985/19, me datë 17.12.2019**

**Zyrtare Ligjore**

Kadishe Shabani

**Gjyqtari**

Adem Shabani

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.